



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-017
Prishtinë, më 17 maj 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 17 MAJ 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi, Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ibrahim Makolli, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Sasha Rashiq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 maj 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 maj 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 maj 2011.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare që do të mbahen më 19 maj 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 19 maj 2011, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
5. Debat parlamentar lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, me mbështetje të Grupit të deputetëve nënshkrues,
6. Miratimi i Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Media për formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
8. Shqyrtimi i Propozimi të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur, për zgjedhjen e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, për vitin 2010,
11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010,

13. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010,
14. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010,
15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010,
16. Debat parlamentar lidhur me bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me Interpolin dhe Europolin, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, të mbështetur edhe nga deputetë të tjerë.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozimin-vendimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.2 Kërkesa e Komisionit për Legjislacion dhe Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, për vijë të veçantë buxhetore

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e cekur më lartë, konstatoi që lidhur për këtë të diskutohet edhe njëherë, në njërën nga mbledhjen e radhës të Kryesisë.

3.3 Propozimi për debat parlamentar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me gjendjen e pensionistëve në Republikën e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale që ta përgatisë një Informatë për gjendjen e pensionistëve në Republikën e Kosovës dhe t'ia dërgojë Kuvendit, mbi bazën e së cilës do të zhvillohet debati parlamentar.

3.4 Kërkesa e ish - anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, z. Sllobodan Petroviq, për pagesën e shpenzimeve me rastin e vizitës zyrtare të realizuar në SHBA

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë

VENDIM

I lejohet pagesa e shpenzimeve në vlerë prej 370, 08 euro, ish-anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, z. Slllobodan Petroviq, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në SHBA, nga dt. 30 janar deri më 5 shkurt 2011.

Pika shitesë:

1. Propozimi i Këshillit Gjyqësor për emërimin e Organit përzgjedhës të Pavarur, për zgjedhjen e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kryesia, këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për shqyrtim në mbledhjen plenare që do të mbahet më dt. 19 maj 2011.

2. Propozimi i deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga grupi i deputetëve nënshkrues lidhur me renditjen e pikës së veçantë në mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për shqyrtim në mbledhjen plenare që do të mbahet më dt. 19 maj 2011.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **11:35** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.